

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E HËNË 31 TETOR 2022

E para, pavarësisht se ka vite që diskutohet për reformën dhe është një prej reformave më të rëndësishme që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve për qytetarët, por edhe me përmirësimin e cilësisë të shërbimeve për qytetarët, sot Kryeministri ka zgjedhur të mos jetë prezent, pavarësisht se kjo duhet të ishte një prej ditëve që duhej të përballej me argumentet kundër të një reforme, e cila është bërë e gjitha në mënyrë të njëanshme.

E dyta, çdo ditë tjetër mund të mungonte Kryeministri, por sot, ditën e Halloween-it, duhet të ishte prezent, sepse është gogoli që ka larguar 700 mijë shqiptarë nga vendi. Pra, të paktën të ishte sot për të larguar shpirtrat e këqij, ashtu siç ka larguar 700 mijë qytetarë shqiptarë nga vendi, pavarësisht se sa herë që i përmenden shifra për të treguar problemet në këtë vend, nuk merret me faktet dhe të luftojë fenomenet, por lufton mediat.

Kur i përmendin largimin masiv, sulmon Top Channel-in; kur i përmendin largimin e mjekëve, kërcënon studentët për t'i ndaluar të ikin; kur i përmendin varfërinë, sulmon News 24-n; kur i përmendin krimin, sulmon portalet. Pra, e bën në mënyrë të përhershme sepse nuk njeh faktin, që pastaj të mund ta përmirësojë, por merret gjatë gjithë kohës me mediat. Meqenëse ra fjala, pa diskutim që kështu do të ishte për një Kryeministër, i cili shumicën e kohës qëndron në avion, sepse, sipas të dhënave të publikuara, 1/3-n e periudhës së qeverisjes ka qenë jashtë Shqipërisë dhe po sipas të dhënave të mediave, vetëm për fluturime janë shpenzuar rreth 22 milionë dollarë.

Meqenëse po flasim për performancën dhe eficiencën e bashkive, dhe po marr shembull qarqe të vogla, si Gjirokastra, Dibra, nëse doni edhe Korça, po t'i marrësh bashkë të gjitha bashkitë e këtyre qarqeve, nuk i kanë 22 milionë dollarë, aq sa ka shpenzuar Kryeministri me avionin e tij personal. Kolegët që kanë qenë në Komisionin e Reformës Territoriale më thanë se ekspertët e Partisë Socialiste kanë thënë se rritja e taksave është në nivelin 217%. Kjo është arritja për qytetarët? Qeveria ka arritur të rrisë taksat me reformën e re me 217% dhe është përmirësuar me një nivel shumë të vogël. Aq dobët është sa një pjesë e bashkive janë sot drejt falimentimit, siç e pranon edhe vetë qeveria, duke mbledhur kryebashkiakët monistë, të zgjedhur në mënyrë të njëanshme.

Pra, e vetmja arritje që përmend qeveria gjatë gjithë kohës apo edhe në diskutimet e sotme, është që kanë arritur t'u marrë shpirtin njerëzve. Pra, kjo është e vetmja arritje. Si ka mundësi? Si do të arrijë të kontaktojë dhe të jetë afër shërbimeve apo ta ketë pushtetin afër qytetari i një njësie apo një fshati në Korçë, kur kryetarin e bashkisë së Korçës nuk e takojnë dot as deputetët e Partisë Socialiste? As ata që e kanë aty nuk e takojnë dot. Si e keni bërë ndarjen që dilni dhe thoni sot "ndahet me copëza", "ata bajraktarë" e kështu me radhë? Bajraktarë janë këta që keni vendosur ju. E keni përqendruar pushtetin vetëm në disa duar njerëzish. Më shumë se 15 prej tyre, një pjesë i keni ende nëpër gjykata, janë njerëz me rekorde të tmerrshme kriminale, përdhunues, trafikantë droge, kurse ju dilni dhe thoni sot që keni dhënë zgjidhje. Cila është zgjidhja që keni dhënë?

E keni marrë njësinë e Pojanit, më e madhja në bashkinë e Maliqit, dhe e keni bashkëngjitur aty për interesa elektorale, kurse ne themi të bëjmë bashkinë e fushës, që lidhen me njëra-tjetrën gjeografikisht dhe që kanë interesa të përbashkëta ekonomike. Pra, të kemi një bashki në fushë, që fermerët të kenë interesa të përbashkëta, se e keni çuar në qendër, në Maliq, dhe ndërkohë keni futur fshatin Zvirinë të njësisë Pirg pjesë të 100 Fshatrave. Asnjë investim nuk është bërë në fshatin më të madh të zonës, as në rrugë dhe as në kanalizime, as në Zëmlak, as në Zvezdë, në asnjë prej fshatrave. Çfarë investimi keni bërë? Kujt i intereson?

Për sa i përket bashkisë së Korçës, ku u vjen radha njërive administrative të fshatrave të Korçës të marrin ndonjë shërbim, kur vetë Korça është e ndarë si me thikë, ca të nënës, ca të njerkës? Gjysma e qytetit, që voton Partinë Socialiste, shndrit dhe ka investime, kurse gjysma tjetër është si në geto. Duket sikur janë dy qytete të ndryshme. Diskriminim masiv. Të gjitha lagjet kryesore dhe më të populluarat të qytetit të Korçës janë lënë pas dore për shkak të një diskriminimi që bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga bashkia.

Çfarë po ju themi ne? Po ju themi që njësinë Voskop, njësinë Voskopojë, që e keni marrë nga një cep dhe ia keni dhënë bashkisë së Korçës, ta nxjerrim njësi më vete, ashtu siç ka qenë; që njësinë e Drenovës, që tradicionalisht ka qenë më vete, ta bashkojmë me njësitë Dvoran dhe Vithkuq dhe ta bëjmë një të vetme. Disa kolegë këtu përmendin emra fshatrash dhe u duket sikur njohin Shqipërinë. Pa diskutim, siç kanë qenë zonat elektorale, Starova duhet të jetë më vete nga Pogradeci, sepse për shkak të rrugës, Mokra ka më afër Përrenjasin sesa Pogradecin, që të kenë edhe interesa që i bashkojnë, të kenë mundësi t'i njohin ata që zgjedhin, por, pa diskutim, të mos bëjë askush llogari elektorale. Ne nuk jemi nisur nga llogaritë elektorale, siç jeni nisur ju.

Diskutimi që bëhet këtu është banal, sepse ju thoni gjatë gjithë kohës “do ta shikoni ju që ne do t’i fitojmë edhe këto zgjedhje”. Kush po niset mbi këto premisa? Pse mendoni ju që jemi nisur mbi këto premisa? Bëni ju kundërpropozimin tuaj, për të thënë që këtyre njësive do t’u shtojmë njësi të tjera për të arritur një dakordësi. Kush e ka bërë llogarinë këtu që do të fitojmë ne? Jo, janë njësi administrative që mund të fitohen përsëri nga përfaqësues të Partisë Socialiste, por do t’i humbisni kështu siç janë zgjedhjet, sepse e keni bërë baltë dhe populli do t’ju marrë përpara.

Nuk ka më hile para votës së qytetarëve për të qëndruar në pushtet. Logjika që të ulemi në një tryezë për Reformën Administrative-Territoriale, të bëjmë sikur bëjmë diçka dhe pastaj të vijmë këtu në mënyrë pa diskutim fyese për qytetarët, se ne e dimë çfarë jeni, duke thënë në mënyrë të prerë me thikë që ne kemi arritur se u kemi marrë shpirtin qytetarëve, ndërkohë që në të gjithë fshatrat janë zbrazur zona dhe lagje të tëra, nuk shkon. Ka ndodhur shpopullimi masiv i zonave.

Shikoni pak cilat kanë qenë prioritetet tuaja apo ato që mendonit se do të arrinit në momentin që e propozuat këtë reformë. Thatë që kjo reformë do të ulë numrin e punonjësve, sepse është rritur në mënyrë abuzive, si dhe do të rrisë eficiencën, por ndërkohë e ka rritur numrin e punonjësve në mënyrë katastrofike.

Ju i keqpërdorni bashkitë për të punësuar patronazhistë dhe njerëz që jetojnë jashtë, për të kërcënuar njerëzit me ndihmën ekonomike dhe për të luajtur me bukën e gojës të njerëzve për interesa thellësisht politike. Nuk doni t’ia dini për njerëzit, por njerëzit do t’ju marrin para në këto zgjedhje. Faleminderit!